رئاسة الشؤون الدينية
بالمسجد الحرام والمسجد النبوي

Shqip | ألباني | دَفْنُ المَوتَى فِي المَسَاجِدِ

Varrosja e të vdekurve në xhami

Autori: Hoxha i nderuar
Abdulaziz ibn Abdullah ibn Baz

ⓒ جمعية خدمة المحتوى الإسلامي باللغات ، ١٤٤٨هـ

بن باز ، عبدالعزيز
دفن الموتى في المساجد - ألباني. / عبدالعزيز بن باز ؛ جمعية خدمة المحتوى الإسلامي باللغات - ط١. .- الرياض ، ١٤٤٨هـ
٦ ص ؛ ..سم

رقم الإيداع: ١٤٤٨/٤٠٥٧
ردمك: ٩٧٨-٦٠٣-٥١٧-٤٧٤-٩

دَفْنُ المَوتَى فِي المَسَاجِدِ

Varrosja e të vdekurve në xhami

لِسَمَاحَةِ الشَّيْخِ العَلَّامَةِ
عَبْدِ العَزِيزِ بْنِ عَبْدِ اللهِ بْنِ بَازٍ
رَحِمَهُ اللهُ

Autori: Hoxha i nderuar
Abdulaziz ibn Abdullah ibn Baz

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Broshura e njëmbëdhjetë:
Varrimi i të vdekurve në xhami

Me emrin e Allahut! Lavdërimi i takon Allahut! Salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij dhe mbi ata që ecin sipas udhëzimit të tij. E më tej:

Lexova gazetën «El-Hartum» të datës: 17/4/1415 h.; dhe pashë se në të ishte botuar një njoftim për varrosjen e Sejjid Muhamed el-Hasan el-Idrisit pranë babait të tij, në xhaminë e tyre në qytetin Um Durman...

Nisur nga detyra e këshillimit të muslimanëve dhe kritikimit të së keqes që Allahu na e ka ngarkuar, e pashë të arsyeshme të tërheq vëmendjen se varrosja në xhami është çështje e palejuar, madje është prej rrugëve që shpien në shirk (idhujtari), dhe prej veprave të hebrenjve dhe të krishterëve, për të cilat Allahu i ka qortuar dhe i Dërguari i Zotit, -sal-lallahu alejhi ue sel-lem- i ka mallkuar, siç ceket në sahihun e Buhariut dhe të Muslimit, nga Aisheja, -radijallahu anha!-, se Profeti, sal-lallahu alejhi ue sel-lem!, ka thënë:

«لَعَنَ اللَّهُ الْيَهُودَ وَالنَّصَارَى، اتَّخَذُوا قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ مَسَاجِدَ».

"Allahu i mallkoftë hebrenjtë dhe të krishterët, ata i shndërruan varret e të dërguarve në faltore!"

Në “Sahihun” e Muslimit shënohet se Xhundub ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se Profeti ﷺ ka thënë:

«أَلَا وَإِنَّ مَنْ كَانَ قَبْلَكُمْ كَانُوا يَتَّخِذُونَ قُبُورَ أَنْبِيَائِهِمْ وَصَالِحِيهِمْ مَسَاجِدَ، أَلَا فَلَا تَتَّخِذُوا الْقُبُورَ مَسَاجِدَ؛ فَإِنِّي أَنْهَاكُمْ عَنْ ذَلِكَ».

"Vërtet, ata që kanë qenë para jush i shndërruan varret e profetëve dhe të devotshmëve të tyre në faltore, mos i shndërroni varret në faltore, sepse unë ju ndaloj nga kjo!" Hadithet që kanë këtë kuptim janë të shumta.

Është obligim për muslimanët në çdo vend – si qeveritë ashtu edhe popujt –: ta kenë frikë Allahun, të ruhen prej asaj që Ai e ka ndaluar, dhe t’i varrosin të vdekurit e tyre jashtë xhamive, ashtu siç bënin Profeti ﷺ dhe shokët e tij, -Allahu qoftë i kënaqur me ta!-, duke i varrosur të vdekurit jashtë xhamive, dhe kështu veproi edhe brezi i mirë pas tyre.

Sa i përket ekzistencës së varrit të Profetit ﷺ dhe të dy shokëve të tij, Ebu Bekrit dhe Umerit, – Allahu qoftë i kënaqur me ta! –, në xhaminë e tij ﷺ, kjo nuk merret si argument për varrosjen e të vdekurve në xhami, sepse ai ﷺ u varros në shtëpinë e tij – në shtëpinë e Aishes, – Allahu qoftë i kënaqur me të! –, pastaj u varrosën pranë tij dy shokët e tij. Kur Uelidi ibn Abdul-Melik e zgjeroi xhaminë, e futi dhomën brenda saj. Kjo ndodhi në krye të shekullit të parë të Hixhretit. Dijetarët e kundërshtuan një

gjë të tillë, por ai e mendoi se kjo nuk duhej ta pengonte zgjerimin dhe se çështja ishte e qartë e nuk kishte arsye për keqkuptim.

Me këtë bëhet e qartë për çdo mysliman, se Profeti ﷺ dhe dy shokët e tij, nuk u varrosën në xhami, dhe futja e tyre në të për shkak të zgjerimit nuk është argument për lejimin e varrimit në xhami, sepse ata nuk janë në xhami, por janë në shtëpinë e tij ﷺ, dhe se vepra e El-Uelidit nuk është argument i vlefshëm për askënd në këtë çështje. Argumenti është në Librin e Allahut dhe dhe Sunnetin e Pejgamberit, dhe në konsensusin e brezit të parë të umetit –Allahu qoftë i kënaqur me ta–, dhe na bëftë prej pasuesve të tyre me punë të mira.

E shkrova këtë artikull si këshillë dhe lirim nga përgjegjësia, më datë: 14/5/1415 h.

Vetëm Allahu e jep suksesin. Salavatet dhe selamet qofshin për Profetin tonë Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe ata që i ndoqën ata në mirësi!

❋❋❋

حرمين

رئاسة الشؤون الدينية
بالمسجد الحرام والمسجد النبوي

رسالة الحرمين

Message of The Two Holy Mosques

Guidance content for the visitors of the Holy Mosque and the Prophet's Mosque in languages.

978-603-517-474-9